

L I G J
Nr. 8826, datë 5.11.2001

PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR. 7564, DATË 19.5.1992,
“PËR TË DREJTËN E AUTORIT”

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Në ligjin nr.7564, datë 19.5.1992 “Për të drejtën e autorit”, ndryshuar me ligjet nr.7923, datë 19.4.1995, nr.8594, datë 6.4.2000 dhe nr.8630, datë 3.7.2000 bëhen këto shtesa:

Neni 1

Në fund të nenit 50 shtohet neni 50/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 50/1

Përbëjnë kundërvajtje administrative shkeljet e mëposhtme:

a) Përdorimi i pronësisë artistike, nga subjekte fizike dhe juridike, pa lejen e autorit, ose pa kontratë me shoqëritë e mbrojtjes së të drejtave të autorëve, shqiptarë dhe të huaj, në respektim të marrëveshjeve ndërkombëtare të nënshkruara nga Republika e Shqipërisë.

b) Mospagimi në afat i detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i kontratave ose i autorizimeve midis autorëve shqiptarë ose të huaj ose shoqërisë që mbron të drejtat e tyre, me përdoruesit e pronësisë artistike.”.

Neni 2

Në fund të nenit 50/1 shtohet neni 50/2 me këtë përmbajtje:

“Neni 50/2

Shkeljet e parashikuara në nenin 50/1 të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, quhen kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë nga inspektorët e kontrollit të Policisë Tatimore në përbërje të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Këta inspektorë, përveç vjeljes së gjobave që parashikohen më poshtë, i detyrojnë përdoruesit të bëjnë edhe arkëtimin e të drejtës së autorit sipas këtij ligji. Gjambat janë si vijon:

1. Gjobë 100 000–400 000 lekë për përdoruesit e mëdhenj, si radiot dhe televizionet kombëtare, hotelet, prodhuesit (botuesit) e kasetave, videokasetave, kompaktdisqeve (CD), si dhe përdorues të tjerë të pronësisë artistike në fushat e letërsisë, arteve vizuale e fotografisë artistike.

2. Me gjobë nga 50 000–150 000 lekë për përdoruesit e mesëm, si radiot dhe televizionet lokale, diskotekat, pianobaret, restorantet me pistë për vallëzim, pubet, operatorët e internetit, telebingot dhe lojërat e tjera të fatit që zhvillohen me spektakle, sallat me destinacion tjetër, si Pallati i Kongreseve, stadiume ose pallate sporti të lojërave me dorë, kur jepen me qira për koncerte.

3. Me gjobë nga 25 000–90 000 lekë për përdoruesit e vegjël, si kafenetë, baret, restorantet, taverinat, hotelet, motelet dhe sallat e gjimnastikës aerobike.

Procedurat e ankimit dhe të ekzekutimit të masës administrative bëhen në përputhje me ligjin nr.8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 3

Në fund të nenit 50/2 shtohet neni 50/3 me këtë përmbajtje:

“Neni 50/3

Gjobat e vjelura nga përdoruesit e pronësisë artistike në kundërshtim me ligjin kalojnë gjashtëdhjetë për qind në Buxhetin e Shtetit dhe dyzet për qind në llogari të shoqërive të autorëve.”

Neni 4

Në fund të nenit 50/3 shtohet neni 50/4 me këtë përmbajtje:

“Neni 50/4

Ministri i Financave nxjerr udhëzim për mënyrën e kontrollit të përdoruesve të pronësisë intelektuale nga organet e Policisë Tatimore.”

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.3149, datë 16.11.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**